



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality of Prishtina

Datë/a:	25.08.2020
Referenc-ë:	05 Nr.350/02-118697/20 dt. 15.07.2020
Nga/ Od/ From:	Liridon Gashi, zyrtar, Drejtoria e Urbanizmit
Për/ Za/ To:	Muhamet Fazliu (fazliu48@gmail.com)
Përmes/ Preko/ Through:	Mimoza Berisha Prestreshi, u.d. Udhëheqëse e sektorit, Drejtoria e Urbanizmit
CC:	Ardian Olluri, Drejtor, Drejtoria e Urbanizmit
Tema/ Subjekat/ Subject:	Informim

Pas vendosjes së njoftimit publik, për kërkesën me 05 Nr. 350/02-118697/20 dt 15.07.2020, Drejtoria ka pranuar “Ankesë”, përmes e-mail-it, nga Muhamet Fazliu, lidhur me ndërtimit e objektit të përkohshëm afarist – depo.

Pas shqyrtimit të Ankesës, Drejtoria e Urbanizmit, ka konstatuar që ankesa është parashtruar në fazën e njoftimit publik (10.08.2020-14.08.2020), sipas kërkesës së Ima Hasani me 05 Nr. 350/02-118697/20 dt 15.07.2020, për ndërtimin e objektit të përkohshëm afarist – depo, në parcelën kadastrale nr. 44-36, ZK Orlovic, e cila shtrihet në kuadër të Planit Zhvillimor Urban – PZHU.

Pala ankuese, ka parashtruar ankesë, si në vijim:

“Te nderuar kam ankes lidhur me njoftimin publik te dates 10.08.2020 Ne zonen kadastrale 44-36 ZK Orlovic ne baze te kerkeses 05 nr.350/02-118697/20 te dt.15.07.2020.

Jam banor i lagjes afer kesaj parcele (44-36) dhe po ju njofotoj se ne kete lagje jemi 7 shtepi rrespektivisht 8 familje. Ne kete njoftimin publik pytet se a ka qasje te pa kufizuar ne rruge publike dhe infrastruktur publike . Ju njofotoj se ne uje te pishem nuk ka qasje sepse ne kete lagje nuk ka infrastruktur te ndertuar as ka ana e komunes e as nga KUR Prishtina, kur ne fshatin Shkabaj eshte ndertu komplet sistemi i ujit per pije,neve si lagje nuk na kan shti ne at projekt te asaj kohe dmth para 15 vitev dhe ne me vet financim ne munges te mbeshtetjes nga KUR Prishtina kemi vendos gyp uji 1” 1/2 ne largesi 500 metra ku ka qen pika ma e afert e kyqjes ,ky gyp eshte i pa mjaftushem edhe per neve si banor lere ma per nje biznes afarist qfar do qoft ai dhe ne nuk lejojm qasje ne at. Ne edhe rrymen gjithë ashtu kanalizimin para 25 vitev kemi financu vet por ne at kohe dihet qe ka qen nje sistem tjeter, gjithë ashtu edhe rrugen e kemi mirembajt me forca tona deri kur eshte ndertu rruga e re nga ana e komunes rruga “Qemajl Stafa” perkatsisht “Bardhok Biba” ateher eshte ndertu bashk me rrugen edhe kanalizimi edhe rryma, por jo edhe ne gypa te ujit.”

Drejtoria e Urbanizmit, pas shqyrtimit të ankesës ju informon se:

- Bazuar në kërkesën e palës, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor – projektin ideor, për ndërtimin e objektit të përkohshëm afarist - depo, trajtimi i kërkesës bëhet bazuar në rrugën e planifikuar me Planin Zhvillimor Urban - PZHU, dhe se rruga ekzistuese deri në parcelën kadastrale është rrugë e asfaltuar;

- Drejtoria e Urbanizmit, me aktin administrativ – Vendim për kushte ndërtimore, të cilin e lëshon, në kapitull të veçantë **“Kycja në infrastrukturë”** kërkon nga pala marrjen e pëlqimeve në KEDS dhe KUR Prishtina, për vazhdim të proceduarave për marrjen e Lejes së ndërtimit.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës ju informon se ankesa e parashtruar është trajtuar dhe se procedurat e mëtutjeshme do të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje të kompetencave të saj.

Kjo shkresë dorëzohet në 3 (tri) kopje: Në dosje të lëndës 05 Nr.350/02-118697/20 dt.

15.07.2020, kësaj Drejtorie dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

Në formë elektronike: Ankuesit